



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TË BUJQËSISË, PYJEVE, MJEDISIT,**  
**STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS**

**PLAN PËRMIRËSIMI**

**Për shërbimet me akses të kufizuar**

**Bashkia Elbasan – 2025-2026**

Në kuadër të monitorimit të aksesueshmërisë së shërbimeve publike dhe zbatimit të “Hartës së Aksesit në Shërbimet Publike të Bashkisë Elbasan”, është evidentuar nevoja për përmirësimin gradual të aksesit fizik, informativ dhe procedural në një pjesë të njësive administrative dhe zyrave të shërbimit ndaj qytetarëve.

Ky plan hartohet me qëllim:

- përmirësimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara;
- rritjen e aksesueshmërisë së shërbimeve publike;
- lehtësimin e procedurave administrative për kategoritë vulnerabël;
- përmirësimin e informimit dhe orientimit institucional.

**1. Objektivat e planit**

- Përmirësimi i aksesit fizik në institucionet publike;
- Rritja e aksesit informativ për qytetarët;
- Përmirësimi i aksesit procedural dhe asistencës administrative;
- Mbështetja e kategorive vulnerabël dhe qytetarëve në nevojë;
- Standardizimi gradual i aksesueshmërisë në njësitë administrative.

**2. Problematikat e evidentuara**

Nga monitorimi i realizuar rezulton se:

- pjesa më e madhe e njësive administrative dhe lagjeve nuk disponojnë rampa aksesimi;
- në disa zyra mungojnë elementët orientues dhe informues;
- ekziston nevoja për forcimin e asistencës procedurale për qytetarët në nevojë;
- aksesit fizik për personat me aftësi të kufizuara mbetet i kufizuar në disa struktura.

### 3. Masat e përmirësimit

<b>Nr</b>	<b>Masa e propozuar</b>	<b>Struktura përgjegjëse</b>	<b>Afati</b>
1	Evidentimi i objekteve me akses të kufizuar	Drejtoria e Sherbimin Social	Periodik
2	Hartimi i planit për vendosjen graduale të rampave	Drejtoria e Investimeve / ASHPU	2026
3	Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese	Sektori I Transportit	2026
4	Përmirësimi i asistencës për qytetarët në procedurat administrative	Zyrat e shërbimit	Vazhdueshëm
5	Mbështetje për qytetarët në nevojë ekonomike dhe sociale	Administratori	Vazhdueshëm
6	Përditësimi periodik i Hartës së Aksesit	Sektori i Statistikave dhe Performancës	Çdo vit
7	Raportim periodik mbi nivelin e aksesueshmërisë	Drejtoria përgjegjëse	Gjashtëmuajor

### 4. Prioritetet kryesore

Prioritet në ndërhyrje do të kenë:

- njësitë administrative pa akses fizik;
- zyrat me fluks të lartë qytetarësh;
- shërbimet që përdoren nga kategori vulnerabël dhe persona me aftësi të kufizuara.

### 5. Rezultatet e pritshme

Përmes zbatimit të këtij plani synohet:

- rritja graduale e aksesueshmërisë në shërbimet publike;
- përmirësimi i kushteve për personat me aftësi të kufizuara;
- forcimi i përfshirjes sociale;
- rritja e cilësisë së shërbimeve publike;
- përmirësimi i aksesit qytetar në informacion dhe procedura administrative.

### 6. Monitorimi dhe përditësimi

Plani do të monitorohet periodikisht nga strukturat përgjegjëse dhe do të përditësohet në bazë të:

- rezultateve të evidentuara gjatë monitorimit;
- nevojave të identifikuara në terren;
- mundësive financiare dhe investuese të Bashkisë Elbasan.